

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 874 Rep.

Nr. 441 Kol.

Akti i Themelimit
Te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
CONSTRUCTION MANAGEMENT ALLIANCE ALBANIA SHPK.
(CMA, ALBANIA SHPK.)

Sot me date 12 nentor 1999, para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht Z. Faruk Slaki, shtetas bosnjak, lindur ne Sarajevo me 17.10.1951, me pasaporte nr. 0936214 dhe Z. David Kent Hardin, shtetas amerikan, lindur ne Poncacity, Oklahoma, U.S.A. me 19.12.1945, me pasaporte nr.015231813.

Personat e mesiperm jane madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ata me vullnetin e tyre te lire e te plote, nepermjet ketij akti themelojne sot, ne emer e per llogari te Construction Management Alliance (Europe) Limited, nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqine dhe kushteve te parashikuara me poshte.



I.

Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte "Construction Management Alliance Albania Shpk.", shkurtimisht "CMA, Albania Shpk.", me poshte e quajtur "Shoqeria".

II.

Objekti

Shoqeria ka per objekt kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, ne fushen e ndertimit dhe çdo aktivitet qe lidhet me te.

III.

Selia

Shoqeria do t'a kete seline ne adresen:

- Rr. Themistokli Germenji 3/1, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, dhe/ose te realizoje çdo lloj pjesemarrje te parashikuar nga ligji ne shoqeri te tjera, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise.



IV.
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin qe ka per objekt per nje periudhe kohore pa afat.

V.
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte USD 1.000, me ekuivalencen ne Leke 130.000 (njqind e tridhjte mije) i ndare ne 130 (njqind e tridhjte) pjese me vlere nga 1.000 (njemije) Leke secila. I gjithë kapitali themeltar eshte nenshkruar dhe shlyer ne te holla nga ortaku i vetem Contruction Management Alliance (Europe) Limited.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar.

Pergjegjësia e ortakut per humbjet e Shoqerise shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

VI.
Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga tre Administratore. Administratoret e pare te Shoqerise te cilet do te qendrojne ne detyre deri ne momentin e shkarkimit te tyre, jane:

- Faruk Slaki - David Kent Hardin - Stewart J. Paperin

VII.
Pergjegjësia Personale

Pasuria e ortakeve, administratoreve, punonjesve dhe/ose agjenteve te Shoqerise, eshte e perjashtuar nga çfaredo lloj detyrimi qe rendon mbi Shoqerine.

Nenshkruar nga ne perfaqesuesit e ortakut te vetem sot me date 12 nentor 1999

FARUK SLAKI

David Kent Hardin
Stewart J. Paperin

Une Noteri i Dhemes se Notereve Tirane, lexoj me ze te larte tekstin e ketij akti. Z. Faruk Slaki dhe Z. David Kent Hardin, per identitetin e te cileve mora dijeni nga dokumentet e tyre personale, njihen me permbajtjen



Akti i Themelimit te shoqerise CMA, ALBANIA Shpk.

Faqja 3 nga 3

e ketij dokumenti nepermjet perkthimit nga shqipja ne anglisht te Znj. Alketa Uruçi, dhe pasi ata e gjejne permbajtjen e Aktit te Themelimit te shoqerise ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire, nenshkruajne rregullisht ne pranine time dhe une Noteri vertetoj kete akt sipas ligjit.


Perktheu nga shqipja ne anglisht:

Alketa Uruçi

Alketa Uruçi

NOTER

Halim Islami



Statuti

I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

**CONSTRUCTION MANAGEMENT ALLIANCE ALBANIA SHPK.
(CMA, ALBANIA SHPK.)**

NENI I
EMERTIMI

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "Construction Management Alliance Albania Shpk.", shkurtimisht "CMA, Albania Shpk.", qe me poshte do te quhet "Shoqeria".

NENI II
PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar shqiptar nepermjet vendimit te Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI III
SELIA

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rr. Themistokli Gërmenji 3/1, Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale dhe/ose te realizojë çdo lloj pjese marrje te parashikuara nga ligji dhe shoqeri te tjera, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, sipas vendimit te Ortakut te Vetem



NENI IV
KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte USD 1.000, me ekuivalencen ne Leke 130.000 (njeqind e tridhete mije) i ndare ne 130 (njeqind e tridhete) pjese me vlere nga 1.000 (nje mije) Leke secila. I gjithë kapitali themeltar eshte nenshkruar dhe shlyer ne te holla nga ortakut i vetem Construction Management Alliance (Europe) Limited.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar.

Pergjegjësia e ortakut per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.



NENI V
OBJEKTI

Shoqeria ka per objekt kryerjen e çdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprim apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, ne fushen e ndertimit dhe çdo aktivitet qe lidhet me te.

NENI VI
KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin qe ka per objekt per nje periudhe kohore pa afat.

NENI VII
ORTAKU I VETEM

Construction Management Alliance (Europe) Limited , shoqeri e regjistruar ne Regjistrin e Shoqerive per Angline dhe Wales, me nr.3812512, me seli ne 9 Cheapside, London, EC2V 6AB, United Kingdom, eshte Ortaku i Vetem i Shoqerise.

Ortaku i Vetem ne perputhje me legjislacionin shqiptar, mund te marre, por pa u kufizuar vetem ne keto, vendime per ndryshimin e ketij Statuti, pjesemarrjen ne shoqeri te tjera, zmadhimin e zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, transferimin teresisht apo pjeserisht te pjeseve te kapitalit te Shoqerise, emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve, emerimin e ekspertit(eve) kontabel te autorizuar, miratimin e bliancit vjetor te Shoqerise dhe te çdo raporti financiar brenda gjashte muajve nga mbyllja e vitit financiar te Shoqerise, shperndarjen e Shoqerise, likujdimin e Shoqerise, emerimin e likuidatorit(eve).

NENI VIII
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

1. Kompetencat.

Pasuria, aktiviteti dhe biznesi i Shoqerise do te drejtohet dhe administrohet nga tre Administratore, te cilet mund te ushtrojne çdo kompetence e mund te kryeje çdo veprim te ligjshem ne emer te Shoqerise me perjashtim te atyre qe ligji apo ky Statut ia rezervon Ortakut te Vetem.

Çdo transaksion ne emer te Shoqerise do te lidhet me nenshkrimin e te pakten njerit prej Administratoreve. Çdo Administrator ka te drejte t'u delegoje me prokure nje pjese apo te gjitha kompetencat e tij personave te trete te caktuar prej tij.

2. Emerimi dhe Kohezgjatja e Mandatit.

Çdo Administrator do te emerohet me vendim te Ortakut te Vetem, dhe do te qendroje ne kete detyre derisa

te emerohet zevendesuesi ose zevendesuesja e tij ose e saj, ose deri ne momentin e doreheqjes, shkarkimit ose vdekjes.

3. Shkarkimi.

Çdo Administrator mund te shkarkohet ne çdo moment me ose pa shkak , me vendim te Ortakut te Vetem.

4. Pergjegjesite.

Administratoret jane sipas rastit individualisht ose solidarisht pergjegjes ndaj Shoqerise ose te treteve per deme si rrjedhoje e shkeljes se klauzolave te ketij Statuti apo te ligjit nga ana e tyre.

NENI IX
EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

Eksperti(et) kontabel i(te) autorizuar do te emerohet(n) me vendim te Ortakut te Vetem ne çdo rast kur nje gje e tille kerkohet nga ligji shqiptar.

NENI X
VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe mbaron me 31 dhjetor 1999.


NENI XI
SHPERNDARJA

Ne çdo moment e per çdo arsye qe arrihet ne shperndarjen e shoqerise, normat per kryerjen e likuidimit dhe emerimin e likuidatorit jane ato qe parashikohen nga ligji shqiptar ne fuqi.

NENI XII
BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.
Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen normat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

Çdo konflikt qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Statuti, si dhe çdo konflikt qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve do te jete objekt i zgjidhjes nepermjet vendimit te Gjykatave shqiptare.





NENI XIII
NDRYSHIMET

Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet, shfuqizohet i teri e te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Ortakut te Vetem.

Nenshkruhet sot me date 12 nentor 1999.

Ne emer e per llogari te:

Construction Management Alliance (Europe) Limited

FARUK SLAKI

DAVID KENT HARDIN

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 875 Rep.

Nr. 442 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me 12 nentor 1999, perpara meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht, Z. Faruk Slaki, shtetas bosnjak, lindur ne Sarajevo me 17.10.1951, me pasaporte nr. 0936214 dhe Z. David Kent Hardin, shtetas amerikan, lindur ne Poncacity, Oklahoma, U.S.A. me 19.12.1945, me pasaporte nr.015231813, persona madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentet identifikuese qe ata mbanin.

Pasi une Noteri, ua lexova dhe ua shpjegova ne prani te perkthyeses Alketa Uruçi, aktin bashkengjitur ketij vertetimi, ata me deklarojne se e kuptojne, e pranojne dhe se e kane hartuar ate ne perputhje me vullnetin e tyre te lire e te plote, dhe e nenshkruajne rregullisht ne pranine time, gje te cilen une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

PERKTHEU

Alketa Uruçi
Alketa

NOTER

Halim Islami

